



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:184975
Datë: 05.02.2025
Numri i dokumentit: 06810349

P.nr.149/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit R.Z. nga fshati..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1985/23 e datës 28.06.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 15.08.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar Agjensia Pyjore - Vlora Gashi Hashani, dëshmitarët S.A., B.G., M.B. dhe i pandehuri R.Z., më datë 05.02.2025 mori dhe publikisht shpalli, më datë 05.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: R.Z. nga i ati A..., e ëma H..., e gjinisë M..., data e lindjes... në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, edhe më parë i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE Më datën 15.10.2023, rreth orës 01:10 minuta, në vendin e quajtur “Mbi Lin mbi Mihaliq”, në rajonin ekonomik pyjor Qyqavica II, III, në pyllin publik, me dashje dhe me qëllim të vjedhjes e në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit mbi Pyjet e Kosovës 2003/03, kishte prerë drunjë dhe atë 105 trungje të llojit shkozë, me diametër 11-13 cm, me gjatësi 9 metër, me vëllim të përgjithshëm 4.20 m³, i cili me vete kishte pasur sharrën motorike me të cilën kishte prerë drunjë si dhe traktorin në të cilin kishte ngarkuar drunjë, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës Agjencisë Pyjore të Kosovës-Drejtorit i Koordinues Rajonal në Mitrovicë dëme materiale në shumë prej 642.60€,

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 349 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: R.Z. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të i'a paguaj të dëmtuarës shumën prej gjashtëqind e katër dhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë cent (642.60) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr. 1985/23 e datës 28.06.2024, kundër të pandehurit R.Z. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.10.2024, ku i pandehuri R.Z. është sjellë nga zyrtarët policorë në bazë të urdhërarrestit të datës 13.09.2024, në këtë seancë të shqyrtimit fillestar i pandehuri lidhur me fajësinë, ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë,

Gjykata pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i vihet në barrë, e njofton të pandehurin se jo më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesë kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndaluar ligjërisht dhe të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshtimit të veprës penale.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të mbajtur më datë 03.02.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri R.Z. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do e përsërisë më veprën dhe i vie keq për atë se çfarë ka ndodhur.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar që i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që ky deklarim i tij gjene mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe e njëjta të i merret si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa si rrethanë rënduese të i merret pasojat që ka shkaktuar vepra e që në mënyrë direkte ndërlidhet me dëmtimin e pasurisë pyjore respektivisht ambientin, po ashtu si rrethanë rënduese të merret edhe faktin se i njëjti është recidivist pasi që edhe është dënuar për vepra të natyrës së njëjtë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar që pranon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe kërkon kompensimin e dëmit material ashtu siç është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin R.Z., i datës 27.03.2024, fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit, i datës 15.10.2023, raporti për dëmin e shkaktuar, i datës 15.10.2024 dhe fotoalbumi në shtojcë i përbërë nga dy foto, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 349 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Vjedhja e pyllit e kryen “*Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale si dhe faktin se është në gjendje të dobët ekonomike dhe është mbajtës i familjes, ndërsa

si rrethana rënduese gjykata ka gjetur rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo veprë penale për mjedisin në të cilin jetojmë, faktin që i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre dhe te natyrave të tjera e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.997/2019 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 25.02.2020, për veprën penale Vjedhja e Pyllit, aktgjykim P.nr.225/2021 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 06.06.2022, për veprën penale Vjedhja e Pyllit, aktgjykim P.nr.174/2022 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 10.06.2022, për veprën penale Vjedhja e Pyllit, aktgjykim P.nr.245/2020 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 22.05.2023, për veprën penale Vjedhja e Rënd, aktgjykim P.nr.147/2024 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 08.10.2024 për veprën penale Vetëgjyqësia.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) vite, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”.*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij

aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.148/2024, datë 05.02.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.